



BURIMET PËR NJUJORKEZËT EMIGRANTË

PAVARËSISHT STATUSIT TUAJ TË EMIGRACIONIT,
QYTETI I NJU-JORKUT ËSHTË I GATSHËM T'JU NDIHMOJË.**Ndihma ligjore për emigracionin**

Për ndihmë ligjore falas e të sigurt lidhur me emigracionin, telefononi 800-354-0365, nga e hëna në të premte, nga ora 9:00 deri në 18:00.

**Karta e identifikimit për qytetin e Nju-Jorkut**

Aplikoni për një IDNYC, e cila është karta bashkiake pa pagesë e identifikimit për të gjithë banorët e qytetit të Nju-Jorkut të moshës 10 vjeç e lart. Rinovoni online ose rezervoni një takim për t'u regjistruar, telefononi 311 ose vizitoni faqen nyc.gov/idnyc

**Kurset e gjuhës angleze**

Merrni pjesë në kurset falas të gjuhës angleze kudo dhe kurdo. Vizitoni faqen wespeaknyc.cityofnewyork.us për më shumë informacion.

**Kujdesi shëndetësor**

NYC Health + Hospitals (H+H) mund t'ju ofrojë kujdes emergjent, kujdes bazë shëndetësor, kontrole mjekësore, imunizime dhe më shumë. Telefononi 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692) që të drejtoheni në qendrën më të afërt. Për t'u regjistruar në planet e sigurimit shëndetësor, duke përfshirë programin NYC Care, telefononi 646-NYC-CARE (646-692-2273) ose vizitoni faqen nycare.nyc

**Shëndeti mendor**

Për mbështetje konfidenciale dhe lidhje me burimet e kujdesit të shëndetit mendor dhe përdorimit të substancave, telefononi 888-692-9355 ose 988, ose dërgoni mesazh me tekstin WELL në numrin 65173. Njujorkezët mund të vizitojnë faqen nyc.gov/mentalhealthaccess për burime në shumë gjuhë rreth shërbimeve të shëndetit mendor në qytetin e Nju-Jorkut, ose të përdorin direktorinë online 988 të qytetit të Nju-Jorkut në adresën nyc.gov/mentalhealthservices për të gjetur shërbimet e shëndetit mendor.

**Emergjencat**

Në raste emergjente, telefononi 911. Një emergjencë është çdo situatë që kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia, shërbimet zjarrfikëse ose ambulanca. Sipas ligjit, Departamenti i Policisë i qytetit të Nju-Jorkut (New York City Police Department) nuk mund të kërkojë statusin e emigracionit të viktimave të krimeve, të dëshmitarëve, ose personave të tjerë që kërkojnë ndihmë.

**Edukimi publik**

Të gjithë fëmijët e qytetit të Nju-Jorkut të grupmoshës nga 4 deri në 21 vjeç mund të frekuentojnë shkollat publike. Për t'u regjistruar, vizitoni faqen schools.nyc.gov/fwc ose telefononi 311.

**Burimet dhe informacionet e përgjithshme të qytetit**

Keni nevojë të aksesoni burimet e qytetit ose dëshironi të raportoni një problem? Telefononi 311 ose vizitoni faqen portal.311.nyc.gov

**Linja e ndihmës së shpejtë e qytetit të Nju-Jorkut për çështjet e emigrantëve**

Telefononi linjën tonë të ndihmës së shpejtë në numrin 212-788-7654 nga e hëna në të premte, nga ora 9:00 deri në orën 17:00, ose na dërgoni email në adresën askmoia@cityhall.nyc.gov



BURIMET PËR NJUJORKEZËT EMIGRANTË

PAVARËSISHT STATUSIT TUAJ TË EMIGRACIONIT, JU GËZONI TË DREJTA.

Shmangni mashtrimet lidhur me emigracionin

Nëse keni nevojë për këshilla ligjore rreth emigracionit, komunikoni vetëm me avokatë të licencuar ose me përfaqësues të akredituar nga Departamenti i Drejtësisë (Department of Justice, DOJ). Mund të gjeni një listë të ofruesve të akredituar e të njohur në faqen nyc.gov/immigrationfraud

Të drejtat lidhur me zbatimin e masave për emigracionin

Qyteti i Nju-Jorkut nuk merret me zbatimin e masave për emigracionin. Ju gëzoni të drejta edhe në rast se kontaktoheni nga organet federale ligjzbatuese për emigracionin. Vizitoni nyc.gov/knowyourrights ose telefononi linjën tonë të ndihmës së shpejtë pa pagesë në numrin **800-354-0365**

Të drejtat e punonjësve

Ju keni të drejtën e lejes për shkak të sëmundjes, të drejtën e pagës minimale, të pagesës së orëve shtesë dhe më shumë në kuadër të ligjit të qytetit të Nju-Jorkut. Vizitoni nyc.gov/workers për burime ose telefononi **212-436-0380**

Raportimi i diskriminimit

Ngacmimet dhe diskriminimi janë të jashtëligjshëm sipas ligjit të qytetit të Nju-Jorkut "Për të drejtat e njeriut". Për të raportuar rastet e diskriminimit, telefononi **212-416-0197** ose vizitoni nyc.gov/reportdiscrimination

Mbrojtja kundër dhunës në familje

Qyteti i Nju-Jorkut është i gatshëm t'ju ndihmojë në rast se po përjetoni abuzim. Mund të vizitoni faqen nyc.gov/nychope ose të telefononi linjën e ndihmës së shpejtë kundër dhunës në familje të qytetit të Nju-Jorkut në numrin **800-621-HOPE**

Të drejtat e qiramarrësve

Ju duhet ndihmë për ndonjë problem lidhur me dëbimin ose me qiradhënësin tuaj? Vizitoni nyc.gov/tenantprotection ose telefononi **311** dhe thoni "tenant helpline" (linja e ndihmës për qiramarrësit) për ndihmë ligjore falas

E drejta për strehim

Ju keni të drejtë të kërkonit strehim nëse po përballeni me mungesën e strehimit. Aksesoni shërbimet e strehimit duke vizituar qendrën e caktuar pritëse të Departamentit të Shërbimeve për të Pastrehët (Department of Homeless Services, DHS). Mësoni më shumë duke telefonuar **311**

Mbrojtja e konsumatorit

Keni probleme me një biznes? Ju gëzoni të drejta si konsumator. Paraqitni një ankesë duke vizituar faqen nyc.gov/consumers ose telefononi **311**